



Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr. 10  
Prishtinë 10000  
Republika e Kosovës  
T/F: +381 38 746 206  
E: [ridea.institute@gmail.com](mailto:ridea.institute@gmail.com)  
W: [www.ridea-ks.org](http://www.ridea-ks.org)

# GJENDJA E KËRKIMEVE NË KOSOVË

*financed by*

Austrian

 Development Cooperation

Prishtinë, nëntor 2012



Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr.10  
Prishtinë 10000  
Republika e Kosovës  
T/F: +381 38 746 206  
E: [ridea.institute@gmail.com](mailto:ridea.institute@gmail.com)  
W: [www.ridea-ks.org](http://www.ridea-ks.org)

# GJENDJA E KËRKIMEVE NË KOSOVË

*financed by*

Austrian  
 Development Cooperation

Ky studim është përkrahur nga Agjencioni Austriak për Bashkëpunim. Pikëpamjet e prezantuara në këtë publikim jo domosdoshmërisht korrespondojnë me pikëpamjet e Agjencionit Austriak për Bashkëpunim. Ky publikim mund të kopjohet pjesërisht apo në tërësi, për aq kohë sa pranohet apo njihet burimi i tij original.

## Tabela e Përmbajtjes

<b>1.</b>	<b>Përmbajtja, qëllimet dhe metodologjia e projektit.....</b>	<b>4</b>
1.1.	Rëndësia dhe qëllimet e projektit .....	4
1.2.	Përshkrim i shkurtër i projektit.....	4
1.3.	Metodologjia.....	5
1.4.	Pyetësi.....	6
1.5.	Grupi i synuar dhe përfituesit.....	6
<b>2.</b>	<b>Kërkimet në Kosovë: Kuptimi, problemi dhe proceset ligjore e institucionale .....</b>	<b>7</b>
2.1.	Terminologjia.....	7
2.2.	Analiza e problemit.....	8
2.3.	Struktura ligjore dhe institucionale .....	9
<b>3.</b>	<b>Gjendja e kërkimeve (akademike apo/dhe shkencore) në Kosovë – Prania apo përmasat e aktiviteteve hulumtuese në fusha të ndryshme të studimit .....</b>	<b>12</b>
3.1.	Shkaqet apo faktorët e gjendjes së rëndë kërkimore në Kosovë .....	14
<b>4.</b>	<b>Përfundimet dhe rekomandimet.....</b>	<b>23</b>
<b>5.</b>	<b>Bibliografia.....</b>	<b>27</b>
<b>6.</b>	<b>SHTOJCA.....</b>	<b>31</b>

# 1. Përmbajtja, qëllimet dhe metodologjia e projektit

## 1.1. Rëndësia dhe qëllimet e projektit

**Rëndësia e Projektit** është e përmasave të konsiderueshme, dhe kjo për një numër arsyesh. Kërkimi dhe inovacioni janë dëshmuar të jenë shtylla kyçe të çfarëdo procesi zhvillimor dhe transformues socio-ekonomik dhe politik. Prandaj, kërkimet paraqiten themelore dhe të pazëvendësueshme jo vetëm për veten e tyre (për të ekzistuar si të tilla), por edhe për përfitime të shoqërisë së tërë. Dhe derisa gjendja ekzistuese e kërkimeve shkencore apo akademike del të jetë e një niveli të pakënaqshëm dhe të pamjaftueshëm, kjo e bën nevojën për një Raport si ky edhe më të ngutshëm.

**Qëllimi kryesor** i këtij Projekti është që të kuptojë si shtrirjen ose përmasat e kërkimeve akademike apo shkencore në Kosovë, ashtu edhe rëndësinë dhe përdorimin praktik të rezultateve të këtyre kërkimeve, përfshirë identifikimin e problemeve ekzistuese dhe rekomandimin e zgjidhjeve të përshtatshme alternative.

**Rezultati përfundimtar** është ky studim në formë të raporti gjithëpërfshirës, i cili synon të shërbejë si mjet i besueshëm informimi për proceset vendimmarrëse. Instituti RIDEA do të kujdeset që gjetjet dhe rekomandimet e raportit të arrijnë vendimmarrësit apo *lojtarët* relevant dhe me ndikim në sferën e kërkimeve.

## 1.2. Përshkrim i shkurtër i projektit

Ky Projekt heton gjendjen ekzistuese të hulumtimeve akademike dhe/ose shkencore në Kosovë. Në proces, synon që të kuptojë problemet dhe mangësitë në këtë sferë, si dhe mënyrat për përmirësim të gjendjes ekzistuese.

Kushtet e tanishme, në veçanti në relacion me investimet në fushën e kërkimeve, nuk dalin të jenë te favorshme, derisa përmirësimet në këtë sferë (si në kuptim të rritjes së resurseve të alokuara apo të njohjes më të gjerë shoqërore) mund të prodhojnë efekte dhe rezultate të jashtëzakonshme ekonomike dhe shoqërore.

Sfondi i Projektit, pra, është i krijuar nga një mungesë e përgjithshme e veprimtarive kërkimore ose e veprimtarive relevante kërkimore dhe, për pasojë, e rezultateve të dëshirueshme.

Grupi i synuar përbëhet kryesisht nga hulumtues, studiues apo shkencëtar nga Kosova. Sidoqoftë, Projekti synon të shërbejë si një platformë për diskutim dhe ndryshim në qasjet dhe proceset vendimmarrëse të institucioneve përkatëse publike dhe private në lidhje me kërkimet.

Përfundimisht, siç tashmë është thënë, qëllimi i Projektit mbetet të kuptuarit e gjendjes ekzistuese të kërkimeve dhe inovacionit në Kosovë, dhe përmes kësaj, të identifikimit të problemeve dhe ofrimit të zgjidhjeve të duhura.

Rezultati i pritur është një diskutim i rigjallëruar institucional dhe shoqëror në lidhje me gjendjen e kërkimeve dhe rolin e rëndësishëm të tyre në shoqëri, ngritjen e vetëdijes publike, dhe disa hapa të caktuar institucional si reagim i pritur ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të Projektit.

### 1.3. Metodologjia

Ky Projekt ka për qëllim të bëjë një matje cilësore dhe objektivist të identifikueshme të gjendjes së kërkimeve apo hulumtimeve në Kosovë. Për të arritur këtë qëllim, është zhvilluar një diskutim i gjerë me institucione relevante dhe përfaqësues të sferave të ndryshme, universitare dhe tej-universitare, përfshirë intervista (me përfaqësues vendës dhe ndërkombëtar) dhe vlerësime krahasimtare e analiza të dokumenteve relevante; këto paraqesin edhe mjetet kyçe metodologjike të hetimit të pyetjes së paraqitur. Sigurisht, duke përdorur këto metoda, ideja ka qenë që në proces të identifikohen dhe shpërfaqen edhe rrugët që çojnë drejt zhvillimit dhe nxitjes së kërkimit dhe inovacionit në Kosovë.

Përfundimisht, janë përdorur këto tri metoda kryesore të hulumtimit:

- ***Së pari***, intervista me përfaqësues të niveleve vendimmarrëse dhe me profesorë e studiues të ndryshëm të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë (dhe nga fusha të dijes që përfshijnë si shkencat shoqërore ashtu dhe ato natyrore). Duhet thënë, sidoqoftë, se një numër i konsiderueshëm i institucioneve, publike dhe private, universitare dhe qeveritare, janë përfshirë në kuadër të grupit që ka qenë subjekt i intervistimit. Kështu, lista e institucioneve prej të cilave vijnë të intervistuarit është si në vijim:

- (1) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- (2) Këshilli Kombëtar i Shkencës;
- (3) Universiteti i Prishtinës (zyra e Rektorit, Këshilli Drejtues; dhe Senati i Universitetit);
- (4) Njësitë akademike individuale (zyrat e dekanëve; dhe e pakta një anëtar i personelit akademik të njësisë). Instituti është siguruar që këto njësi akademike të jenë sa më diverse, në mënyrë që të arrihet një kuptim sa më i plotë dhe më i gjerë i gjendjes së kërkimeve, pra duke përfshirë shkencat shoqërore, humanitetet dhe shkencat natyrore;

- (5) Një numër substancial i bartësve privatë të arsimit të lartë<sup>1</sup>;
  - (6) Agjencia e Akreditimit të Kosovës; dhe
  - (7) Institucione ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe janë ose kanë qenë të përfshira në projekte mbështetëse në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimeve në Kosovë.
- **Së dyti**, përmes përdorimit dhe analizës së rezultateve dhe gjetjeve të raporteve të Agjencisë Kosovare të Akreditimit në lidhje me aspektin e kërkimeve; dhe
  - **Së treti**, përmes grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave për të njëjtën temë nga raportet e projekteve dhe të institucioneve ndërkombëtare (siç janë Raportet vjetore të Progresit të Komisionit Evropian) ose/dhe raportet apo strategjitë përkatëse të institucioneve vendëse (si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë apo vetë universitetet).

#### 1.4. Pyetëtori

Për të zbatuar hapin e parë dhe kyç metodologjik të Projektit (pra, intervistat), një seri e pyetjeve të paracaktuara, me qëllim të arritjes së objektivave të synuara, kanë qenë të domosdoshme. Në këtë mënyrë, për të arritur deri te grumbullimi i informacionit të nevojshëm dhe realizmi i qëllimeve të projektit, është hartuar një pyetësor gjithëpërfshirës prej 20 pyetjeve. Teksti i plotë i pyetësorit i është bashkëngjitur këtij Raporti si Shtojcë.

#### 1.5. Grupi i synuar dhe përfituesit

Grupi parësor i synuar janë hulumtuesit, studiuesit ose shkencëtarët që janë të vendosur ose veprojnë në Kosovë. Një nën-grup ose grup i ndërlidhur janë edhe studentët që ndjekin programe studime të nivelit të orientuar nga kërkimet, si studimet e doktoratës ose programet *Master* me komponent të theksuar hulumtuese.

Sa u përket përfituesve të mundshëm nga ky raport studimi, këto janë një grup i institucioneve kyçe që janë të përfshira në çështjet e hulumtimeve ose të disenjuara për t'u marrë me këtë sferë të veçantë. Kështu, këto institucione, të cilat mund të përfitojnë nga ky Projekt, janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Këshilli Kombëtar i Shkencës; Universiteti i Prishtinës dhe bartësit e tjerë publikë të arsimit të lartë, si dhe bartësit privatë të arsimit të lartë në Kosovë. Në fund, gjetjet dhe informacioni i grumbulluar nga ky Projekt mund të jetë i dobishëm për donatorë të ndryshëm ndërkombëtar dhe institucione të tjera të interesuara.

---

<sup>1</sup> Ndërsa, një pjesë e vogël e bartësve të arsimit të lartë privat nuk janë përgjigjur në ftesën e RIDEA-s për intervistim.

## 2. Kërkimet në Kosovë: Kuptimi, problemi dhe proceset ligjore e institucionale

### 2.1. Terminologjia

Për të krijuar një kuptim më të qartë të subjektit të këtij Raporti, është e pashmangshme nevoja e ofrimit të një kuptimi të nocionit qendror të “kërkimeve”. Si për shumë nocione, ka patjetër edhe përkufizime ose kuptime të ndryshme. Një kuptim shumë i gjerë i shprehjes “kërkim” mjaftohet me mbledhjen ose grumbullimin e të dhënave, informacioneve dhe fakteve për avancimin e dijes. Në këtë kuptim, leximi i një libri ose hulumtimi dhe mbledhja e informacionit në internet mund të cilësohet si një lloj i kërkimit.

Përkufizimi më rigoroz i kërkimit shkencor ose akademik (që është subjekt trajtimi nga ky Raport), ka të bëjë me kryerjen e një studimi metodologjik me qëllimin për të provuar një hipotezë ose për të dhënë përgjigje ndaj një pyetjeje apo problemi specifik. Pra, gjetja e një përgjigjeje definitive është qëllimi qendror i ndërmarrjes kërkimore. Tutje, kërkimi lypset të jetë sistematik dhe të ndjekë një seri hapash dhe një standard rigoroz; pra, është i organizuar dhe planifikuar mirë, si dhe përfshinë leximin dhe analizën e literaturës ekzistuese ose kërkimeve të mëparshme relevante dhe vlerësimin e saj në dritë të problemit që kërkon zgjidhje. Këto rregulla janë përgjithësisht të njëjta, ndonëse mund të ndryshojnë në varësi të disiplinave të dijes. Në cilindo rast, një kërkim i mirëfilltë, pavarësisht nëse është në fushat e shkencave ekzakte, ekonomike apo historike, kërkon një lloj interpretimi dhe mendimi të vetë personit që ndërmerr kërkimin.

Ligjërisht, në Kosovë, është Ligji Nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore ai që përcakton kuptimin e shprehjes “kërkim” dhe llojet ose tipet e kërkimit. Kështu, sipas nenit 2.2, “veprimtaria kërkimore-shkencore paraqet punën krijuese sistematike që ndërmerret me qëllim të kërkimit dhe zhvillimit të njohurive të reja, të shfrytëzimit dhe zbatimit të tyre në praktikë”<sup>2</sup>. Përgjithësisht është ky kuptim që kihet parasysh kur përdoret kjo shprehje në këtë studim: pra, një ndërmarrje sistematike, që ndjekë një sërë hapash rigoroz të planifikimit dhe shkrimit, me qëllim kërkimi të njohurive të reja apo zhvillimi të atyre ekzistuese, si dhe shfrytëzimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Ky kuptim, në një format më të detajuar dhe nën-ndarje më specifike, mund të marrë formën e kërkimeve të tri llojeve në vijim, siç ato janë klasifikuar në Ligjin Nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore: (1) kërkimet fundamentale (ose bazë); (2) kërkimet aplikative; dhe (3) kërkimet zhvillimore<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2011) *Ligji Nr. 2004/42 Për veprimtarinë kërkimore – shkencore*. E disponueshme: [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=35&Itemid=28](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=35&Itemid=28) (vizituar më 30. 10. 2012).

<sup>3</sup> Po aty, fq. 2.

Sipas nenit 3.2 të Ligjit Nr. 2004/42, kërkimet fundamentale ose bazë përfshijnë kërkimet e thelluara teorike, eksperimentale ose të kombinuara që ndërmerren për arritjen e njohurive të reja ose për kërkimin e fushave të reja të hulumtimit me qëllim të qartësimit të dukurive dhe të modeleve fizike me interes afatgjatë të zbatimit të tyre<sup>4</sup>. Paragrafi tjetër i të njëjtës dispozitë (3.3) ofron kuptimin e kërkimeve aplikative, sipas të cilit, janë “paraqesin punën krijuese të mbështetur në rezultatet e kërkimeve fundamentale, e cila ndërmerret për zgjidhjen e çështjeve praktike të caktuara”<sup>5</sup>. Kategoria e tretë ligjore, ajo e kërkimeve zhvillimore, sipas nenit 3.4 të këtij Ligji, përfshinë “punën krijuese të mbështetur mbi bazën e kërkimeve bazë dhe të atyre aplikative, që ndërmerret me qëllim të aplikimit të proceseve të reja apo përsosjen e tyre”<sup>6</sup>.

Siç tashmë e thënë, ky Raport studimi, në pjesët e veta respektive, trajton secilën prej këtyre kategorive të mësipërme (si kërkimet bazë dhe përmasat e tyre, ashtu dhe rëndësinë e zbatimit e tyre praktik, etj.), që kolektivisht do të përdoren si pjesë të nocionit “kërkim” ose “kërkime.”

## 2.2. Analiza e problemit

Problemet udhëheqëse që justifikojnë ndërhyrjen (në këtë rast, përmes këtij studimi) janë pothuajse ekskluzivisht të lidhura me një nivel shumë të ultë të veprimtarive kërkimore. Siç thuhet në Programin Kombëtar të Shkencës të Republikës së Kosovës “kërkimi dhe zhvillimi teknologjik është ende një ndërmarrje marginale në Kosovë”<sup>7</sup>. Në të vërtetë, në radhë të parë, nuk ka të dhëna të besueshme dhe të plota për gjendjen e kërkimeve, sikundër që nuk del të ketë ndonjë sistem të strukturuar që u kërkon institucioneve relevante të organizojnë dhe raportojnë veprimtaritë e tyre kërkimore.

Nga Akreditimi Institucional i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (qershor 2012), çështja e kërkimit është më tepër çështje e “iniciativave individuale”<sup>8</sup>. Një gjë e tillë del edhe nga rezultatet e analizës së pyetësorit të këtij Projekti (shih kapitullin vijues të këtij Raporti). Për këtë arsye, Raporti i Akreditimit Institucional rekomandon themelimin e një qendre kërkimore shkencore, e cila do të inkurajonte stafin që të përqendrohet në kërkim shkencor që mbështetet nga institucioni. Në rastin e Fakultetit Juridik, ndërkaq, Raporti Final i Vlerësimit vë në pah mungesën e planeve të hulumtimeve personale, dhe prandaj rekomandon që “të gjithë akademikët duhet të kenë plane personale të hulumtimit të cilat janë të shqyrtuara rregullisht nga

---

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Këshilli Kombëtar i Shkencës (2010) – *Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës*, Prishtinë 30. 03. 2010. E disponueshme: [http://www.masht-gov.net/advCms/documents/PKSH\\_FINAL\\_Shqip.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/PKSH_FINAL_Shqip.pdf) (vizituar më 30. 10. 2012).

<sup>8</sup> Agjencia e Akreditimit e Kosovës (2012) *Raport mbi akreditimit Institucional dhe Programor, Universiteti Publik i Prishtinës – Fakulteti Ekonomik* Qershor 2012. E disponueshme: [http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi\\_i\\_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB\\_Prishtin%EBs:Fakulteti\\_Ekonomik:Procedura\\_e\\_vlersimit\\_2012](http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi_i_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB_Prishtin%EBs:Fakulteti_Ekonomik:Procedura_e_vlersimit_2012) (vizituar më 30. 10. 2012).



Fakulteti Juridik<sup>9</sup>. Në cilindo rast, analiza e këtij studimi flet për një nivel të pakënaqshëm të kërkimit, si për sa i përket shtrirjes apo gjerësisë ashtu dhe cilësisë dhe rëndësisë së kërkimit që prodhohet. Përveç raporteve të akreditimeve institucionale dhe intervistave individuale (shih kapitullin vijues të këtij Raporti), kjo po ashtu konfirmohet edhe nga institucione të besueshme ndërkombëtare.

Për më shumë, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën (i vitit 2011) raporton vetëm “progres të kufizuar” në sferën e përafrimit të kërkimeve dhe inovacionit në Kosovë me standardet evropiane<sup>10</sup>. Në fakt, për dimensione themelore siç janë investimet në kërkime, Raporti vëren se “nuk ka pasur fare progres”. Siç theksohet tutje nga ky Raport i Komisionit Evropian, “përpjekje substanciale janë pra të nevojshme për të kontribuar në arritjen e objektivave dhe caqeve të Hapësirës Evropiane për Kërkime dhe Inovacion”<sup>11</sup>.

Pasojat e mëtejme, më të thella të problemit, shkojnë përtej fakteve thjesht të ekzistencës ose mungesës relative të kërkimeve. Rëndësia dhe cilësia e kërkimeve është një problem tjetër i këtij lloji. Po ashtu, observimet e Projektit flasin për një shkallë të theksuar të kërkimeve të zhvilluara me cilësi ose rëndësi të ultë. Më tej, nuk ka të dhëna apo raporte ose analiza të tjera që tregojnë shtrirjen ose nivelin brenda të cilit rezultatet e kërkimeve (për aq sa janë të disponueshme) janë përdorur dhe kanë prodhuar efekte në shoqëri. Aspekte të këtyre dimensioneve janë trajtuar me të intervistuarit e Projektit, dhe rezultatet shfaqen në kapitullin vijues.

### 2.3. Struktura ligjore dhe institucionale

Kosova ka një sërë strukturash ligjore dhe institucionale, të ngritura për qëllime të qeverisjes së çështjeve që kanë të bëjnë me arsimin dhe kërkimet.

Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës përbën legjislacionin themelor të fushës<sup>12</sup>. Ligji kërkon që institucionet (dhe programet) e arsimit të lartë të plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuarra të cilësisë, standarde të cilat vlerësohen nga Agjencia Kosovare e Akreditimit. Sipas nenit 15 të këtij Ligji, të gjithë bartësit e licencuar të arsimit të

---

<sup>9</sup> Agjencia e Akreditimit e Kosovës (2012) *Raport mbi akreditimit Institucional dhe Programor, Universiteti Publik i Prishtinës – Fakulteti Juridik* Qershor 2012. E disponueshme: [http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi\\_i\\_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB\\_Prishtin%EBs:Fakulteti\\_Juridik:Procedura\\_e\\_vlersimit\\_2012](http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi_i_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB_Prishtin%EBs:Fakulteti_Juridik:Procedura_e_vlersimit_2012) (vizituar më 30. 10. 2012).

<sup>10</sup> Komisioni Evropian (2011) *Raporti i Progresit për Kosovën 2011*. E disponueshme: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/ks\\_rapport\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf) (vizituar më 30. 10. 2012).

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2011) *Ligji Nr. 04/L-037 Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës*, Nr. 14/9. E disponueshme: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20arsimin%20e%20larte%20%28shqip%29.pdf> (vizituar më 30. 10. 2012).

lartë u nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë nga Agjencia Kosovare e Akreditimit<sup>13</sup>.

Në fushën e kërkimeve, Kosova ka Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, që përcakton bazën institucionale dhe orientimin strategjik për kërkime dhe inovacion<sup>14</sup>. Po ashtu, ky Ligj themelon Këshillin Kombëtar të Shkencës, me detyrë të përkujdesjes e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kosovë (neni 53 i Ligjit). Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë dhe, sipas nenit 54 të Ligjit, ka këto kompetenca:

- (a) I paraqet Qeverisë së Kosovës propozimin e Programit Kombëtar-Shkencor;*
- (b) Vlerëson në aspektin krahasimtar gjendjen në veprimtarinë kërkimore-shkencore, pozitën dhe zhvillimin e saj në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare;*
- (c) Jep mendimin për nevojën e themelimit të instituteve kërkimore-shkencore;*
- (d) Propozon dhe nxit ndërmarrjen e masave për përparimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;*
- (e) Shqyrton dhe jep mendimin për çështje të tjera të rëndësishme për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Kosovës, sipas kërkesës së Kuvendit të Kosovës.*

Këshilli ka zhvilluar Programin Kombëtar të Shkencës, një program pesë vjeçar që synon të përmirësojë sektorin e kërkimeve. Programi është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Programi ka caktuar pesë plus një prioritet, ndonëse ka theksuar se ekziston nevojë e madhe për të rigjallëruar veprimtarinë kërkimore-shkencore në pothuajse të gjitha disiplinat<sup>15</sup>. Këto pesë fusha prioritare për veprimtarinë kërkimore-shkencore, sipas Programit Kombëtar të Shkencës, janë:

- (1) Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi;
- (2) Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit;
- (3) Kërkimet shkencore në mjekësi;
- (4) Studimet shoqërore dhe ekonomike;
- (5) Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.

Fusha e Teknologjisë Informative dhe Komunikimeve, ndërkaq, është cilësuar si prioritet ndër-horizontal, që mund të shfaqet në cilindo prej fushave të mësipërme. Për përcaktimin e këtyre prioritetëve, Këshilli ka marrë parasysh këta faktorë: rëndësinë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit; numrin dhe cilësinë e burimeve njerëzore në vend dhe në diasporë; kushtet e infrastrukturës kërkimore shkencore; kontributin për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar të Kosovës; ekzistimin e potencialit për arritjen e rezultateve kërkimore-shkencore dhe

---

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Shih fusnotën nr. 1.

<sup>15</sup> Shih fusnotën nr. 6.

zbatimin e tyre brenda dhe jashtë; si dhe ekzistimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e caktuar<sup>16</sup>.

Në përgjithësi, mund të thuhet se në fushën e kërkimit dhe të inovacionit në Kosovë, ekziston korniza relevante ligjore dhe institucionale.

Sidoqoftë, përtej kornizës ligjore dhe institucionale, për të arritur objektivat e nevojshëm, edhe ato që dalin nga një Marrëveshje e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian, ka nevojë të qartë të rritjes së investimeve në kërkime. Nevojat për zhvillim ekonomik dhe shoqëror e kërkojnë në mënyrë të veçantë një gjë të tillë. Për këtë qëllim, siç theksohet edhe në Raportin Analitik për Kosovën 2012 të Komisionit Evropian, është e nevojshme të krijohet një fond i posaçëm që mbështet veprimtaritë e hulumtuesve apo studiuesve dhe ndërton kapacitetet e institucioneve kërkimore në Kosovë<sup>17</sup>. Sfidat kryesore ndërkohë mbeten mungesa e personelit të kualifikuar shkencor, numri i vogël i studentëve të doktoratës, pajisjet e pamjaftueshme laboratorike dhe “know-how” (di-si) teknik joadekuat. Për më tepër, komuniteti kërkimor në Kosovë mbetet i izoluar në relacion me komunitetin shkencor ndërkombëtar.

---

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Komisioni Evropian (2012) *Raporti Analitik për Kosovën 2012*. E disponueshme: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_feasibility\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf) (vizituar më 30. 10. 2012).

### **3. Gjendja e kërkimeve (akademike apo/dhe shkencore) në Kosovë – Prania apo përmasat e aktiviteteve hulumtuese në fusha të ndryshme të studimit**

Siç është elaboruar në seksionet e mëhershëm të këtij studimi, kërkimet akademike dhe/ose shkencore janë esenciale për progresin dhe zhvillimin e gjithanshëm të çdo shoqërie. Natyrshëm, nga ky rregull nuk bën përjashtim as shoqëria kosovare. Por, si ka qenë dhe si paraqitet për momentin gjendja e kërkimeve akademike dhe shkencore në Kosovë?

Duke pasur parasysh kontekstin e përgjithshëm politik dhe shoqëror që ka mbretëruar në Kosovë në dekadën e fundit të shekullit XX, apo dhe më herët, atëherë lirshëm mund të konkludohet se gjendja në këtë aspekt ka qenë e mjerueshme dhe nën çdo nivel. Megjithatë, pas vitit 1999 në Kosovë janë krijuar rrethana të reja që duket se kanë krijuar një ambient më të përshtatshëm për punën kërkimore dhe shkencore.

Por, sa është shfrytëzuar kjo mundësi e re dhe sa ka ndikuar në nxitjen dhe zhvillimin e punës kërkimore në Kosovë?

Gjetjet e këtij studimi nuk janë dhe aq premtuese sa i përket zhvillimeve rreth punës kërkimore dhe shkencore në dekadën e fundit në Kosovë. Në fakt, duket se ekziston një vlerësim i përgjithshëm në mesin e studiuesve të fushave të ndryshme se gjendja e kërkimeve në Kosovë është në stadin më të ultë të saj<sup>18</sup>. Ky konstatim i kësaj gjendjeje të rëndë në fushën e kërkimeve shkencore në Kosovë shtrihet në të dy sektorët e arsimit të lartë: a) arsimit të lartë publik dhe b) arsimit të lartë privat.

Gjithashtu, kjo situatë e rëndë e kërkimeve shkencore në Kosovë ka një shtrirje të gjerë duke filluar nga shkencat ekonomike dhe shoqërore deri tek ato teknike dhe natyrore. Madje, gjetjet e këtij studimi çojnë në drejtimin se gjendja e kërkimeve shkencore dhe akademike në Kosovë në

---

<sup>18</sup> Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012); Intervistë me Arbnora Krasniqi-Loshaj - Koordinatore për programin e ekonomisë në Kolegjin Victory (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Basri Çapriqin - Profesor në Fakultetin Filologjik të Prishtinës. Ish Kryetar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 12/10/2012); Intervistë me Bujar Dugollin – Dekan i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 4/10/2012); Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012); Intervistë me Ferdiqe Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012); Intervistë me Fetah Podvoricën – Profesor i demografisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 15/10/2012); Intervistë me Ismet Poterën - Zv. drejtor i Institutit Pedagogjik (Prishtinë: 8/10/2012); Intervistë me Kimete Canaj – Koordinatore e projekteve Tempus (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Mo Vazirin – Zv. president për çështje Akademike dhe Zhvillim pranë Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Rrahman Paçarizin – ish Prorektor për Mësim në Universitetin AAB, tani koordinatör për shkencë. Gjithashtu ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 08/10/2012); Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012); Intervistë me Zejnullah Grudën – Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Sali Bashotën – Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Valmir Krasniqin – Botues në revistën Probleme Matematikore (Math problems), Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 16/10/2012).

fusha të ndryshme të ekspertizës është edhe në nivelin e vendeve të Ballkanit Perëndimor<sup>19</sup>. Ndërsa, as që mund të vihet në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore. Për më tepër, duket se ka një pajtim të përgjithshëm në mesin e studiuesve të fushave të ndryshme të studimit se kërkimet shkencore dhe akademike dhe arrijtjet eventuale në këtë fushë në Kosovë janë kryesisht të bazuara në iniciativa individuale të individëve të caktuar, ndërsa mungon përpjekja dhe iniciativa institucionale në këtë drejtim<sup>20</sup>.

Pra, mund të thuhet se ka individë të caktuar brenda shoqërisë kosovare dhe botës akademike në Kosovë të cilët me vetë-iniciativë zhvillojnë hulumtime dhe studime të një niveli të kënaqshëm dhe që i plasojnë dhe publikojnë këto studime në vende të ndryshme perëndimore, por që iniciativa e strukturuar institucionale në këtë rrafsh mungon. Në lidhje me këtë, edhe raporti i Këshillit Kombëtar të Shkencës (2010) thekson që aktivitetet kërkimore ekzistuese janë me karakter bazik dhe, në shumë raste, karakterizohen me nisma individuale, edhe pse, aktualisht, në Universitetin e Prishtinës dhe në institutet e tjera kërkimore në Kosovë punojnë rreth 90 anëtarë të stafit akademik dhe shkencor<sup>21</sup>.

Sa i përket veprimtarisë kërkimore/hulumtuese të kolegëve në fushën përkatëse, në përgjithësi cilësohet të jetë në nivel të dobët. Me ndonjë përjashtim individual, vërehet mungesë e praktikës institucionale për raportim të planeve ose projekteve hulumtuese, njëjtë sikurse edhe të

---

<sup>19</sup> Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012) Intervistë me Basri Çapriqin - Profesor në Fakultetin Filologjik të Prishtinës. Ish Kryetar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 12/10/2012); Intervistë me Bujar Dugollin – Dekan i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 4/10/2012); Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012); Intervistë me Ferdiqe Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012); Intervistë me Fetah Podvoricën – Profesor i demografisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 15/10/2012); Intervistë me Ismet Poterën - Zv. drejtor i Institutit Pedagogjik (Prishtinë: 8/10/2012); Intervistë me Rrahman Paçarizin – ish Prorektor për Mësim në Universitetin AAB, tani koordinator për shkencë. Gjithashtu ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 08/10/2012); Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012); Intervistë me Zejnullah Grudën – Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Sali Bashotën – Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Vjollca Komonin - Ish prodekan për çështje mësimore, prodekan për çështje financiare në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Fadil Musën - Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin e Bujqësisë (Prishtinë: 11/10/2012).

<sup>20</sup> Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012) Intervistë me Basri Çapriqin - Profesor në Fakultetin Filologjik të Prishtinës. Ish Kryetar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 12/10/2012); Intervistë me Bujar Dugollin – Dekan i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 4/10/2012); Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012); Intervistë me Ferdiqe Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012); Intervistë me Fetah Podvoricën – Profesor i demografisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 15/10/2012); Intervistë me Ismet Poterën - Zv. drejtor i Institutit Pedagogjik (Prishtinë: 8/10/2012); Intervistë me Rrahman Paçarizin – ish Prorektor për Mësim në Universitetin AAB, tani koordinator për shkencë. Gjithashtu ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 08/10/2012); Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012); Intervistë me Zejnullah Grudën – Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Sali Bashotën – Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Vjollca Komonin - Ish prodekan për çështje mësimore, prodekan për çështje financiare në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Fadil Musën - Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin e Bujqësisë (Prishtinë: 11/10/2012). Intervistë me Milazim Krasniqin – Shef i Degës së Gazetarisë në Fakultetin Filologjik, ish anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 04/10/2012); Intervistë me Kimete Canaj – Koorditore e projekteve Tempus (Prishtinë: 11/10/2012).

<sup>21</sup> Shih fusnotën nr. 6.

rezultateve në fushën e kërkimeve. Derisa plotësisht mungon raportimi i planeve për kërkime ose projekte hulumtuese, në disa institucione raportimi i rezultateve bëhet kryesisht me rastin e rizgjedhjeve të profesorëve, gjë që bëhet çdo katër vjet<sup>22</sup>. Një nga arsytet për mos-raportim të planeve dhe rezultateve të kërkimeve duket të jetë mungesa e fondeve të alokuara për projekte kërkimore<sup>23</sup>.

Gjithashtu, ka disa institucione ku zhvillohet një punë e caktuar kërkimore, por përgjithësisht mbetet në nivele shumë të ulëta. Ka disa iniciativa për hulumtim në institucionet private por që akoma janë në një pikë fillestare. Gjithashtu, në disa njësi të Universitetit të Prishtinës, siç bie fjala në Fakultetin e Bujqësisë apo të Shkencave Natyrore ka disa iniciativa interesante hulumtuese, por që janë modeste. Megjithatë, ka fakultete ku hulumtimi nuk është çështje që as nuk debatohet dhe është në një pikë pothuajse zero<sup>24</sup>.

Gjithashtu, vërehet dhe mungesë e hulumtimeve jashtëzakonisht të thjeshta dhe jo shumë të kushtueshme. Për ta ilustruar me një shembull, do të mund të thuhej se edhe pemët nëpër qytete mbillen pa ndonjë hulumtim paraprak. Si rrjedhojë dhe në mungesë të kërkimeve, nuk e kemi as idenë se cilat nga pemët (p.sh. bliri apo shkoza) do të mund të ishin më të dobishme në thithjen e gazrave apo pluhurit<sup>25</sup>.

Në pika të shkurtra, nga elaborimi i mësipërm mund të thuhet se gjendja e kërkimeve shkencore dhe/ose akademike në Kosovë mbetet jashtëzakonisht e rënduar dhe brengosëse. Ndërsa, në pjesën më poshtë diskutohen gjetjet e këtij studimi të cilat shpjegojnë faktorët apo shkaqet që shkaktojnë një gjendje të këtillë.

### **3.1. Shkaqet apo faktorët e gjendjes së rëndë kërkimore në Kosovë**

Duke u mbështetur në intervistat e zhvilluara me studiues të fushave të ndryshme, studimi ka identifikuar një sërë shkaqesh, duke filluar nga ato të natyrës financiare deri tek mungesa e resurseve humane. Në fakt, gjetje të tilla vërehen edhe në dokumente të tjera relevante të analizuara duke përfshirë edhe Raportin Analitik për Kosovën (2012) të Komisionit Evropian, ku sfidat kryesore në fushën kërkimore mbeten mungesa e personelit të kualifikuar shkencor, numri i vogël i studentëve të doktoratës, pajisjet e pamjaftueshme laboratorike dhe “know-how” (di-si) teknik joadekuat. Për më tepër, komuniteti kërkimor në Kosovë mbetet i izoluar në relacion me komunitetin shkencor ndërkombëtar<sup>26</sup>.

---

<sup>22</sup>Intervistë me Vjollca Komoni - Ish prodekane për çështje mësimore, prodekane për çështje financiare në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Prishtinë: 10/2012).

<sup>23</sup>Intervistë me Fadil Musën - Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin e Bujqësisë (Prishtinë: 11/10/2012).

<sup>24</sup> Intervistë me Ferdije Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012).

<sup>25</sup> Intervistë me Ismet Poterën - Zv. drejtor i Institutit Pedagogjik (Prishtinë: 8/10/2012).

<sup>26</sup> Shih fusnotën nr. 16.

Më poshtë listohen gjetjet rreth shkaqeve apo faktorëve kryesorë që gjenerojnë një gjendje të këtyre të rëndë në fushën e kërkimeve shkencore. Diskutimi i mëposhtëm dhe radhitja e këtyre shkaqeve është bërë në bazë të një rrjedhe logjike.

#### **a) Mungesa e buxhetit për kërkime akademike/shkencore**

Ky studim si shkak primar apo parësor për gjendjen e rëndë në fushën e kërkimeve në Kosovë identifikon mungesën e buxhetit për kërkime. Në fakt, shumica e të intervistuarve theksojnë mungesën e **buxhetit** i cili duhet alokuar për kërkime shkencore nga Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Vlen të përmendet fakti se agjenda e Lisbonës është që deri në vitin 2020 të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe të Evropës të ndajnë rreth 3% nga bruto prodhimi kombëtarë (GDP) për hulumtime shkencore. Kosova por edhe vendet e Ballkanit nuk qëndrojnë mirë në raport me këtë agjendë. Bie fjala, në Ballkanin Perëndimor, shteti që ndan më së shumti për shkencë në kuadër të GDP-së është Kroacia 0.7%, dhe kur krahasohet 0.7%-shi me agjendën e Lisbonës (që është 3% të GDP-së) është tepër larg.

Por, në këtë mes Kosova qëndron fatkeqësisht më së dobëti sepse ndanë vetëm 0.1% nga GDP kombëtare për hulumtime shkencore. Kjo shumë që ndahet nga MASHT konsiston në 1.000.000 Euro që për synim ka financimin e projekteve kërkimore në 6 fusha prioritare të caktuara nga Programi Kombëtarë i Shkencës së Kosovës<sup>27</sup>. Vlen të theksohet fakti se projektet që janë financuar me këto mjete janë nga aspekti social, ekonomik, dhe bujqësorë<sup>28</sup>. Por, siç e vë në pah dhe pjesa paraprake (0.1% e GDP-së) dhe nga shumë të intervistuar të këtij studimi ky buxhet është konsideruar i pamjaftueshëm, për të mos thënë edhe i mjerueshëm<sup>29</sup>. Si pasojë e kësaj vihet

<sup>27</sup> Komisioni Evropian (2011) *Raporti i Progresit për Kosovën 2011*. E disponueshme:

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/ks\\_rapport\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf) (vizituar më 30. 10. 2012).

<sup>28</sup> Intervistë me Mensur Nezirin - Ekspert në Qendrën për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë QITT (Prishtinë: 10/10/2012); Intervistë me Murteza Osdautaj - Departamenti për Shkencë dhe Teknologji - MASHT (Prishtinë: 17/10/2012).

<sup>29</sup> Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012); Intervistë me Arbnora Krasniqi-Loshaj - Koordinatore për programin e ekonomisë në Kolegjin Victory (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Besnik Limaj – Udhëheqës i projekteve vendore në WUS Austria (Prishtinë: 15/10/2012). Intervistë me Basri Çapriqin - Profesor në Fakultetin Filologjik të Prishtinës. Ish Kryetar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 12/10/2012); Intervistë me Bujar Dugollin – Dekan i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 4/10/2012); Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012); Intervistë me Ferdije Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012); Intervistë me Fetah Podvoricën – Profesor i demografisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 15/10/2012); Intervistë me Ismet Poterën - Zv. drejtor i Institutit Pedagogjik (Prishtinë: 8/10/2012); Intervistë me Rrahman Paçarizin – ish Prorektor për Mësim në Universitetin AAB, tani koordinatore për shkencë. Gjithashtu ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 08/10/2012); Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012); Intervistë me Zejnullah Grudën – Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Sali Bashotën – Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Vjollca Komonin - Ish prodekan për çështje mësimore, prodekan për çështje financiare në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Fadil Musën - Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin e Bujqësisë (Prishtinë: 11/10/2012). Intervistë me Milazim Krasniqin – Shef i Degës së Gazetarisë në Fakultetin Filologjik, ish anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 04/10/2012); Intervistë me Kimete Canaj – Koordinatore e projekteve Tempus (Prishtinë: 11/10/2012); Intervistë me Frashër Demaj – Instituti i Historisë i Kosovës (Prishtinë: 9/10/2012).

re mungesa e fondeve për hulumtime vendore dhe për më tepër edhe e fondeve për hulumtime ndërkombëtare në arkiva, biblioteka, muze, parqe arkeologjike të natyrave të ndryshme<sup>30</sup>.

Për më shumë, Raporti i Vlerësimit (2009) nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës thekson mungesën e fondeve si faktorë de-motivues për angazhim të personelit në projekte hulumtuese<sup>31</sup>. Gjithashtu, nevoja për alokim të fondeve është identifikuar edhe nga Raporti Analitik për Kosovën 2012 të Komisionit Evropian ku theksohet se është e nevojshme të krijohet një fond i posaçëm që mbështet veprimtaritë e hulumtuesve apo studiuesve dhe të ndërtoj kapacitetet e institucioneve kërkimore në Kosovë<sup>32</sup>.

Më pastaj vlen të përmendet fakti se përveç mungesës së fondeve të alokuara nga Qeveria, gjithashtu mungojnë edhe fondet nga vetë institucionet e arsimit të lartë privat dhe publik për punë kërkimore. Kjo situatë më së miri mund të përshkruhet nëse i referohemi një përmbledhje të deklaratës së Kryetares së Këshillit Shtetëror për Cilësi:

Ajo çka na ka shqetësuar si agjencion, është se fondet vendore për hulumtim janë simbolike, pothuajse mungojnë fare. D.m.th. nuk ka një nxitje të stafit akademik që të konkurroj, dhe t'i nxisë ata që të bëjnë hulumtime. Edhe në institucionet jashtë vendit (agjencia ka bashkëpunim) në radhë të parë ekzistojnë fonde në nivel kombëtarë, pastaj në nivel të institucionit e mandej fondet tjera ndërkombëtare. Por, tek ne si shtet duhet më shumë të investohet në nxitjen e hulumtimeve, sepse zhvillimi ekonomik pa hulumtime besoj që është i pamundur<sup>33</sup>.

Ka iniciativa të mira ndërkombëtare që institucionet të aplikojnë në grante të vogla për hulumtim që jepen nga komuniteti austriak. Bie fjala është projekti 'Higher-Kos' i cili inkurajon hulumtimin në UP në bashkëpunim me institucionet Austriake. Në kuadër të projektit, hulumtimet shkencore mbështeten me grante për 10 projekte hulumtuese<sup>34</sup>. Por, edhe këto përpjekje akoma mbeten në nivele të ulëta.

Pra, nga ajo që u diskutua më lartë mund të thuhet se vihet re mungesa e buxhetit për kërkime si në nivelin qeveritar (shuma minimale prej 0.1.% e GDP-se) gjithashtu edhe mungesa e buxhetit në nivelin institucional të bartësve privat dhe publik të arsimit të lartë.

#### ***b) Mungesa e vullnetit politik, politikave dhe strategjive të zbatueshme***

Si shkak tjetër për gjendjen e rëndë në Kosovë sa i përket kërkimeve shkencore, nga shumë të intervistuar të këtij studimi përmendet edhe mungesa e vullnetit politik, politikave dhe strategjive të zbatueshme rreth kësaj tematike. Në esencë, MASHT dhe institucionet tjera relevante të Kosovës kanë hartuar dokumente dhe strategji të kohës (p.sh. Plani Kombëtar i Shkencës 2011-

<sup>30</sup> Intervistë me Gëzim Aliun - Hulumtues i pavarur shkencor në Degën e Letërsisë, Instituti Albanologjik (Prishtinë: 17/10/2012).

<sup>31</sup> Agjencia e Akreditimit të Kosovës (2009) *Raport vlerësimi i grupit të ekspertëve që vlerësuat Universitetin e Prishtinës në procesin e ri-akreditimit*. E disponueshme:

[http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi\\_i\\_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB\\_Prishin%EBs](http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi_i_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB_Prishin%EBs) (vizituar më 30. 10. 2012).

<sup>32</sup> Shih fusnotën nr. 16

<sup>33</sup> Intervistë me Ferdije Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012).

<sup>34</sup> Intervistë me Besnik Limaj – Udhëheqës i projekteve vendore në WUS Austria (Prishtinë: 15/10/2012).



2016), por të cilat kanë mbetur vetëm në letër, meqë zbatimi i tyre në praktikë nuk ka ndodhur asnjëherë. Gjithashtu, në linjë me këtë ka dhe argumente të tilla se gjendja është shumë e keqe sidomos kur njerëzit që hartojnë politikat dhe që marrin vendime lidhur me hulumtimet, dhe shkencën dhe edukimin në përgjithësi, janë njerëz që nuk kanë pasur rastin asnjëherë më herët që të bëjnë hulumtime, ose atë çka në botën perëndimore njihet si edukim i lartë<sup>35</sup>. Në këtë linjë, si pasojë e mungesës së disponimit apo vullnetit dhe profesional të menaxhmentit për kërkime shkencore, më tepër preferohen formalitetet<sup>36</sup>.

### *c) Infrastruktura*

Një faktor tjetër që shkakton gjendjen e rëndë në disa fusha të kërkimeve në Kosovë, duket të jetë edhe mungesa e infrastrukturës së nevojshme fizike për kryerjen e mirëfilltë të punës kërkimore. Konkretisht si problem në këtë rrafsh shihet mungesa e hapësirës fizike, infrastruktura fizike (pajisjet dhe aparaturat laboratorike) e pamjaftueshme dhe e stër-vjetruar për kërkime bashkëkohore shkencore<sup>37</sup>. Pra, këtu vërehet një mungesë e infrastrukturës, që nuk krijon parakushtet që të ndodh hulumtimi<sup>38</sup>.

### *d) Programet e doktoratës*

Ky faktor rëndues për gjendjen e kërkimeve në Kosovë shpjegohet me dy çështje të ndërlidhura: (i) mungesa e programeve të mirëfillta kërkimore në fusha të ndryshme të nivelit të Doktoratës; dhe (ii) mundësia për të marrë diploma në disa universitete të vendeve fqinjë për këto nivele të studimit të cilat konsiderohen si të pavlera. Së pari, duket se programet e doktoraturës nuk janë në përputhje me nevojat e ekonomisë<sup>39</sup>. Së dyti, edhe aty ku ekzistojnë këto programe studimi, niveli i hulumtimeve duket të mos jetë në përputhje me kriteret e kërkuara shkencore dhe akademike<sup>40</sup>.

Gjithashtu, duket se në departamentin e matematikës në UP rreth 70% të profesorëve nuk kanë prodhuar madje asnjë student të doktoraturës dhe kjo ndodh si pasojë e mosekzistimit të një plani konkret dhe studentet detyrohen të shkojnë në Tiranë për këtë nivel të studimeve<sup>41</sup>. Por, edhe mundësia e marrjes së titujve akademik në Shqipëri në universitete private, në Maqedoni, në Ohër apo diku tjetër si në Novi-Pazar, Serbi, nuk shihet me sy të mirë nga një pjesë e të intervistuarve. Bile ka të tillë që shprehen se këto diploma të doktoraturës pa asnjë punim

<sup>35</sup> Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012).

<sup>36</sup> Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012).

<sup>37</sup> Intervistë me Frashër Demaj – Instituti i Historisë i Kosovës (Prishtinë: 9/10/2012); Intervistë me Mensur Nezirin, - Ekspert në Qendrën për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë QITT (Prishtinë: 10/10/2012); Intervistë me Agim Gashin – Profesor në Departamentin e Pedagogjisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Besnik Limaj – Udhëheqës i projekteve vendore në WUS Austria (Prishtinë: 15/10/2012); Intervistë me Fetah Podvoricën – Profesor i demografisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 15/10/2012).

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> Intervistë me Besnik Limaj – Udhëheqës i projekteve vendore në WUS Austria (Prishtinë: 15/10/2012);

<sup>40</sup> Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012); Intervistë me Valmir Krasniqin – Botues në revistën Probleme Matematikore (Math Problems), Universiteti i Prishtinës (Prishtinë:16/ 10/2012).

<sup>41</sup> Intervistë me Valmir Krasniqin – Botues në revistën Probleme Matematikore (Math Problems), Universiteti i Prishtinës (Prishtinë:16/ 10/2012).

shkencor, janë pa asnjë vlerë për shkak se ato as që botohen dhe për pasojë kjo ngarendje pas titujve e ka zhvlerësuar punën shkencore<sup>42</sup>.

#### *e) Mësimdhënia vs. puna kërkimore*

Një faktor tjetër hendikepues për gjendjen e rëndë të kërkimeve në Kosovë, është edhe mungesa e vetëdijes për ndërlidhjen në mes të punës kërkimore dhe mësimdhënies tek shumica e bartësve të arsimit të lartë privat dhe publik. Me fjalë të tjera, përqendrimi i profesorëve shtrihet në shumë njësi akademike (katedra) dhe universitete. Së dyti, disa nga universitetet programet e tyre i kanë të ngulfatur me lëndë mësimore, ndërsa komponentën shkencore e kanë të zbehtë<sup>43</sup>. Pra, universitet janë të fokusuara kryesisht në mësimdhënie (mësimdhënia si prioritet) përderisa stafi akademik nuk është i obliguar të kryej veprimtari minimale kërkimore shkencore<sup>44</sup>. Në këto vitet e fundit, MASHT ka filluar të organizoj ‘Javën e Shkencës’ që duket të jetë një ogur i mirë në këtë drejtim, por jo i mjaftueshëm dhe kjo paraqet vetëm një pikë ujë në detin e madh të gabimeve dhe lëshimeve që ka bërë MASHT-i në këtë aspekt.

#### *f) Mungesa e traditës për kërkime shkencore*

Faktor tjetër esencial që influencon gjendjen e rëndë të kërkimeve në Kosovë është edhe vetë mungesa e traditës për kërkime shkencore. Me fjalë të tjera, në krahasim me standardet evropiane, Kosova ka pasur ngecje të mëdha në këtë fushë (sidomos në 20 vitet e fundit), sepse puna kërkimore-shkencore kërkon vërtet ndoshta 5-6 vite për të arritur deri në përfundime konkrete rreth një hulumtimi të thellë<sup>45</sup>. Gjithashtu, vihet re mungesa e traditës që të bëhen hulumtime në mënyrë institucionale, në mënyrë që në një projekt të madh të aplikohet si Universitet apo si departament. Në veçanti, vihet re mungesa e traditës së themelimit të instituteve dhe grupeve hulumtuese në kuadër të fakulteteve ashtu si veprohet në botën perëndimore. Duhet të ekzistojnë bërthamat e hulumtimit, apo fushat e fuqishme të hulumtimit, për shkak që është e pamundur që një institucion të bëjë hulumtim në të gjitha fushat<sup>46</sup>. Por, në esencë këto grupe dhe institute hulumtuese brenda fakulteteve mungojnë. Për shembull, një gjë e tillë (mungesa e një qendre të hulumtimeve) vihet re edhe në një ndër njësitë më të reja të Universitetit të Prishtinës, pra në Fakultetin e Edukimit. Këtu mungon tradita e organizimit, nuk ka qendër apo zyre për hulumtime, dhe ndarje të kompetencave, thjesht shkollaret merren me gjithçka<sup>47</sup>. Për shembull, në fillim të hapjes së Fakultetit të Edukimit, ligjëruesit e këtij fakulteti kanë qenë në Itali që të shohin se si funksionojnë institutet e hulumtimit dhe atje institutet janë

<sup>42</sup> Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012).

<sup>43</sup> Intervistë me Mensur Nezirin, - Ekspert në Qendrën për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë QITT (Prishtinë: 10/10/2012); Intervistë me Ragip Gjoshin - Këshilltar Politik në MASHT (Prishtinë: 11/10/2012).

<sup>44</sup> Intervistë me Agim Gashin – Profesor në Departamentin e Pedagogjisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Besnik Limaj – Udhëheqës i projekteve vendore në WUS Austria (Prishtinë: 15/10/2012); Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012); Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012).

<sup>45</sup> Intervistë me Kimete Canaj – Koordinatore e projekteve Tempus (Prishtinë: 11/10/2012).

<sup>46</sup> Intervistë me Ferdije Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012).

<sup>47</sup> Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012).

shumë të lidhura me njësitë akademike e kjo nuk ndodh në Kosovë<sup>48</sup>. Gjithashtu, e njëjta gjendje sa i përket instituteve kërkimore apo grupeve hulumtuese brenda fakulteteve duket të jetë në një nga fakultetet më të vjetra të UP-së. Bie fjala, brenda këtij fakulteti nuk ka ndonjë institut adekuat në lëminë penale apo fushën kriminologjike, i cili do të jepte kontribut të madh për zhvillimet shoqërore në Kosovë<sup>49</sup>. Ngjashëm, ky studim ka gjetur se në shumë bartës të tjerë të Arsimit të Lartë, grupet apo institutet hulumtuese brenda fakulteteve ekzistojnë vetëm në letër dhe jo në praktikë. Kjo formë e punës apo mos-punës gjithashtu lidhet me faktin se institucionet e mëhershme në përgjithësi kanë pas një përvojë individuale të studimeve, ndërsa ka munguar përvoja ekipore<sup>50</sup>. Por, fatkeqësia qëndron në faktin se pak ose aspak ka ndryshuar në këtë mes që nga përfundimi i luftës në Kosovë në vitin 1999.

Një përjashtim në këtë aspekt, duket se janë kërkimet nga fusha e *letërsisë, gjuhës, kulturës dhe historisë* ku ka të ngjarë se ekziston një traditë kërkimore në këto fusha. Numri më i madh i hulumtimeve në këto fusha, vjen edhe si pasojë e mundësisë buxhetore, pasi që nuk ka nevojë për të pasur laboratorë apo pajisje të veçanta kërkimore për këto fusha. Në këtë kontekst, si shembull pozitiv mund të përmendet edhe seminari i gjuhës shqipe brenda UP-së që ka krijuar një traditë goxha të gjatë dhe të pasur.

#### ***g) Mungesa e lidhjes në mes të kërkimeve, tregut dhe institucioneve***

Si rrjedhojë e gjendjes së rëndë të kërkimeve shkencore në Kosovë, ky efekt negativ zinxhiror lidhet edhe me mungesën e ndërveprimit mes hulumtuesve, tregut dhe/apo institucioneve. Kështu, shumica e të intervistuarve nuk janë kontaktuar nga institucionet vendore me qëllim të konsultimit të ekspertizës së tyre. Megjithatë, vërehet që një numri të vogël të intervistuarve iu është kërkuar ekspertiza nga institucionet ndërkombëtare sikurse GIZ, USAID ose UNICEF.

Poashtu, një numër i vogël nga të intervistuarit përmendin që janë në kontakt me MASHT me qëllim të ofrimit të këshillave në fushat e tyre përkatëse<sup>51</sup>. Por, trendi në këtë rrafsh vazhdon të mbetet negativ. Pra, ka një mungesë të vetëdijes sikurse të institucioneve publike, ashtu edhe të kompanive private për përdorimin e punës kërkimore në veprimtarinë e tyre të përditshme. Siç shprehet një nga të intervistuarit e këtij studimi se nuk kemi hulumtime të tilla të cilat janë bërë fillimisht e pastaj mbi bazën e tyre të jenë bërë reforma apo veprime konkrete institucionale<sup>52</sup>.

Në përgjithësi, duket se nuk ekziston asnjë ndërgjegjësim shoqëror e aq më pak institucional për rëndësinë e lidhjes në mes të punës kërkimore tregut dhe/apo institucioneve publike/private. Për ta ilustruar, mund të përmenden hulumtime periodike që partitë politike dhe institucionet e ndryshme në vendet perëndimore organizojnë për performancën e tyre, për përditshmërinë e publikut. Ndërsa, tek ne këto organizata dhe institucione ende nuk e kanë në planifikimet e veta,

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> Intervistë me Rexhep Gashi – Profesor në Fakultetin Juridik. (Prishtinë: 16/10/2012).

<sup>50</sup> Intervistë me Bajram Kosumin - Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë - Profesor në Degën e Gazetarisë (Prishtinë: 9/10/2012);

<sup>51</sup> Intervistë me Eda Vula – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, E nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 10/2012); Intervistë me Kimete Canaj – Koordinatore e projekteve Tempus (Prishtinë: 11/10/2012).

<sup>52</sup> Intervistë me Eda Vula – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, E nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 10/2012);

përveç në kohë fushatash elektorale, ku edhe bëhen shumë shpejt, sa për sy e faqe, nganjëherë edhe me ngjyresa ideologjike, dhe propagandistike dhe nuk e japin pamjen reale të gjendjes, për qëllimet që financuesit dëshirojnë t'i arrijnë<sup>53</sup>. Në këtë linjë argumentimi, një aspekt tjetër që ndikon në rëndësinë e kërkimeve, është edhe cilësia e kërkimeve që bëhen. Në këtë aspekt, metodologjia dhe origjinaliteti shkencor i kërkimeve shpeshherë është subjekt dyshimi, si pasojë e së cilës edhe mund të shfaqet mungesa e ndërlidhjes mes kërkimit dhe tregut apo institucioneve. Kjo, për faktin se shumë kërkime nuk shfrytëzojnë të gjitha burimet relevante, dhe nuk përkojnë me realitetin në terren, atëherë edhe rezultatet e tyre nuk gjejnë zbatim<sup>54</sup>.

Në anën tjetër, ka raste kur mund të ketë kërkime relevante por ato nuk përdoren nga shoqëria dhe institucionet. Për shembull, mund të përmendim kërkime të ndryshme në lidhje me fushën e arsimit si p.sh. hulumtimet në lidhje me braktisjen e fëmijëve në shkollë apo kërkime tjera në fusha shumë specifike si p.sh. në lidhje me vlerësimin e gjendjes ekologjike të ujërave, rezultatet/rekomandimet e të cilave *nuk* janë përdorur nga hisedarët relevantë për të cilët është dedikuar kërkimi<sup>55</sup>. Me fjalë të tjera, mungon materializimi i rezultateve të hulumtimit, që ato të shfrytëzohen dhe të vihen në praktikë dhe sado që të jetë hulumtimi i mirë dhe rezultatet e dobishme, nëse ato mbesin të pashfrytëzueshme atëherë themi se nuk mund të vlerësohen të dobishme për shoqërinë<sup>56</sup>.

#### ***h) Mungesa e revistave të universiteteve me recension ndërkombëtar***

Një shkak tjetër për gjendjen e rëndë në fushën e kërkimeve në Kosovë ka të ngjarë të jetë dhe mungesa e revistave akademike vendore me recension ndërkombëtar dhe impakt faktor. Nëse fillojmë dhe e zërthejmë këtë problematikë me Universitetin e Prishtinës, atëherë mund të thuhet se ne jemi dëshmitarë që universiteti më i vjetër në Kosovë (42 vjet ekzistencë), ende nuk ka një revistë shkencore me impakt faktor ndërkombëtarë në të cilin shkollarët do të mund t'i botonin punimet e tyre<sup>57</sup>. Një gjë e tillë për një revistë shkencore me impakt faktor ndërkombëtar duket se është kërkuar shpeshherë edhe nga drejtuesit e këshillit botues të UP-së, por deri me tani nuk ka ndodhur<sup>58</sup>. E njëjta situatë paraqitet edhe tek shumica e bartësve të arsimit të lartë privat, pra mungesa e revistave akademike vendore me recension ndërkombëtar dhe/apo impakt faktor ndërkombëtar. Njëri problem është statusi i Kosovës, i cili shkakton që Kosova të mos ketë numrin serik standard ndërkombëtar (ISSN). Ky kod identifikues ndërkombëtar shërben për të identifikuar titullin e publikimeve në revistën respektive. Mungesa e kodit ISSN, shkakton që rezultatet e publikuara të mos mund të lexohen nga lexuesit jashtë shtetit të Kosovës. Si pasojë, kjo është duke shkaktuar de-motivimin e hulumtuesve potencial për të zhvilluar dhe shpallur rezultatet e tyre brenda vendit. Ndërsa, vlen të përmendet se ekzistojnë disa revista brenda

<sup>53</sup> Intervistë me Milazim Krasniqin – Shef i Degës së Gazetarisë në Fakultetin Filologjik, ish anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 04/10/2012).

<sup>54</sup> Intervistë me Zejnullah Grudën - Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 10/2012).

<sup>55</sup> Intervistë me Ferdiqe Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetërorë të Cilësisë, dhe Profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 10/2012); Intervistë me Ismet Poterën - Zv.drejtor i Institutit Pedagogjik (Prishtinë: 8/10/2012).

<sup>56</sup> Po aty.

<sup>57</sup> Intervistë me Bujar Dugollin – Dekan i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 4/10/2012).

<sup>58</sup> Intervistë me Sali Bashotën – Drejtor i Bibliotekës Kombëtare (Prishtinë: 11/10/2012).

fakulteteve apo bartësve të arsimit të lartë publik dhe privat ku publikohen studime të ndryshme, por të cilat nuk kanë recension ndërkombëtar apo impakt faktor ndërkombëtar. Për shembull, në Fakultetin Juridik brenda Universitetit të Prishtinës botohet një revistë që i dedikohet botimit të studimeve dhe të artikujve të ndryshëm, nga të gjitha lëmitë juridike. Por, problemi është se kjo revistë nuk ka treg, sikurse edhe nuk ka edhe njerëz që prodhojnë. Gjithashtu, problem është sigurimi i mjeteve financiare për botimin e një reviste që publikohet 3 herë në vit<sup>59</sup>. Për më shumë, revista të karakterit akademik (pa recension ndërkombëtar apo impakt faktor) në intervale të rregullta publikon Instituti Albanologjik siç janë: “Gjurmime albanologjike”, “Gjuha shqipe”, “Albanologji”.

Ndërsa, në degën e gazetarisë brenda UP-së gjendja duket të jetë madje edhe më e keqe. Këtu nuk ka asnjë revistë të tillë që do mund të plotësonte ndonjë nevojë minimale të brendshme brenda kësaj njësie akademike<sup>60</sup>. Për më keq, në Fakultetin e Arteve kanë ekzistuar disa numra të revistave të teatrit, që janë botuar 10-12 botime, por janë ndal në mungesë të fondeve<sup>61</sup>. Në këtë aspekt, ka mungesë të fondeve edhe për botimin e teksteve apo librave universitare, ku shumica e autorëve i botojnë ato me mjete të veta, d.m.th. nuk investohet jo vetëm në mbrojtjen e autorëve dhe autorësisë por nuk ndihmohet as në çështje elementare<sup>62</sup>. Në linjë me këtë, MASHT ka një linjë buxhetore për publikime, por që duket të jetë shumë e ulët dhe nuk mund të financohen shumë nga publikimet kërkimore-shkencore. Në pika të shkurtra, mund të thuhet se mungesa e revistave me recension ndërkombëtar dhe/apo impakt faktor ndërkombëtar është një shkak tjetër rëndues për gjendjen e rëndë të kërkimeve në Kosovë.

#### ***1) Pamundësia për qasje në revista akademike ndërkombëtare dhe burime tjera relevante shkencore***

Si faktor tjetër që është përmendur nga shumë të intervistuar si jashtëzakonisht rëndues për gjendjen e kërkimeve në Kosovë, është edhe mungesa apo pamundësia për qasje në revistat e ndryshme akademike dhe shkencore ndërkombëtare. Pra, me fjalë të tjera mungesa e qasjes në informatat e përditësuara dhe relevante shkencore të nivelit ndërkombëtar<sup>63</sup>. Kjo më së miri ilustron faktin se kemi raste kur një studiues si individ ka revista shkencore të parapaguara më shumë se institucioni i arsimit të lartë ku punon.

Bie fjala, Universiteti i Prishtinës nuk e ka asnjë revistë të parapaguar ndërkombëtare nga fusha e shkencave politike, ndërsa një studiues mund t’i ketë 2-3 të tilla<sup>64</sup>. Por, një studiues nuk mund të ketë dhe të krijoj bibliotekën personale që do të ishte kompatible me atë të një universiteti normal perëndimor. Pra, sot 13 vite pas luftës në vend se të ekzistonte një bazë solide për t’u

<sup>59</sup> Intervistë me Zejnullah Grudën – Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 17/10/2012).

<sup>60</sup> Intervistë me Bajram Kosumin - Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë- Profesor në Degën e Gazetarisë (Prishtinë: 9/10/2012)

<sup>61</sup> Intervistë me Ilire Vincën –Profesoreshë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 19/10/2012).

<sup>62</sup> Intervistë me Zejnullah Grudën – Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 17/10/2012).

<sup>63</sup> Intervistë me Mo Vazirin – Zv. president për çështje akademike dhe Zhvillimore pranë Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Besnik Limaj – Udhëheqës i projekteve vendore në WUS Austria (Prishtinë: 15/10/2012); Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012).

<sup>64</sup> Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012).

marrë me hulumtime shkencore, përfshirë edhe qasjen në revista të ndryshme shkencore, ne ende flasim vetëm për sanime të gjendjes emergjente në këtë fushë.

Në fakt, në vitet e fundit është shtuar literatura në gjuhën shqipe dhe angleze në Bibliotekën Kombëtare<sup>65</sup>. Por, sa i përket qasjes në revistat akademike ndërkombëtare një gjë e tillë duket se ka stagnuar apo është një alternativë krejtësisht e re (përfshijto këtu platformën elektronike EBSCO).

#### *j) Mungesa e shkathtësive për të aplikuar në projekte/donacione ndërkombëtare*

Element apo faktor tjetër që ka influencuar gjendjen e rëndë të kërkimeve në Kosovë, është edhe mungesa e një përvoje për të aplikuar në fondet e donatorëve ndërkombëtar. Pra, vihet re mungesa e shkathtësive dhe njohurive se si duhet të draftohen projektet dhe aplikohet për fondet e ndryshme ndërkombëtare për kërkime (p.sh. për fondet e Komisionit Evropian)<sup>66</sup>. Kjo ndërlikohet gjithashtu edhe me mosnjohjen e gjuhës angleze nga një pjesë e mirë e studiuesve dhe hulumtuesve, sidomos atyre mbi moshën 50-55 vjeçare. Për pasojë këta studiues nuk do të jenë në gjendje të draftojnë projekte kërkimore në gjuhën angleze. Për më tepër, edhe nëse do kenë mundësi të qasjes në literaturën relevante në gjuhën angleze, do ta kenë të pamundur ta konsultojnë për shkak të njohurive të kufizuara të komunikimit dhe shkrimit në këtë gjuhë.

#### *k) Bashkëpunimi i kufizuar ndërkombëtar në fushën e kërkimeve*

Bashkëpunimet ndërmjet institucioneve vendore me ato ndërkombëtare janë kryesisht bashkëpunime me qëllim të implementimit të programeve studimore ose shkëmbimit të studentëve në nivelin Bachelor ose Master. Programi TEMPUS në mes Universitetit të Prishtinës, Grazit dhe Galway mund të përmenden si programe Master që iu ofrohen studentëve, ekzistojnë programe ku universitetet private me ato ndërkombëtare bëjnë shkëmbimin e studentëve ose hartimin e kurrikulave të përbashkëta studimore<sup>67</sup>. Megjithatë, hulumtimi tregon se institucionet vendore nuk bashkëpunojnë me ato ndërkombëtare në sferën e kërkimit.

Gjithashtu, gjetjet e këtij studimi reflektojnë një mungesë financimi të pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare të stafit akademik nga institucionet kërkimore dhe të arsimit të lartë. Si rrjedhojë, kjo i detyron ligjëruesit dhe profesorët që një gjë e tillë ta bëjnë me mjete vetanake dhe kështu është bërë shumë pak në mënyrë institucionale në nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar (sidomos nga Universiteti i Prishtinës)<sup>68</sup>. Në esencë, ekzistojnë raste kur stafi akademik ftohet dhe merr pjesë në emër të institucionit përkatës, ndërsa të gjitha aspektet

<sup>65</sup> Intervistë me Sali Bashotën – Drejtor i bibliotekës Kombëtare (Prishtinë: 11/10/2012).

<sup>66</sup> Intervistë me Bajram Kosumin - Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë- Profesor në Degën e Gazetarisë (Prishtinë: 9/10/2012); Intervistë me Murteza Osdautaj - Departamenti për Shkencë dhe Teknologji – MASHT (Prishtinë: 17/10/2012); Intervistë me Agim Gashin – Profesor në Departamentin e Pedagogjisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 17/10/2012).

<sup>67</sup> Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 10/2012); Intervistë me Rrahman Paçarizi – ish Prorektor për Mësim në Universitetin AAB, tani koordinator për shkencë. Gjithashtu ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 08/10/2012).

<sup>68</sup> Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012); Intervistë me Rrahman Paçarizin – ish Prorektor për Mësim në Universitetin AAB, tani koordinator për shkencë. Gjithashtu ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 08/10/2012).

financiare të pjesëmarrjes apo udhëtimit mbulohen nga iniciativa individuale<sup>69</sup>. Rrjedhimisht, shumë studiuues të cilët ftohen në konferenca kërkimore të nivelit ndërkombëtar mund të mos marrin pjesë për shkak të aspektit financiar.

Ndërsa, në rrafshin individual, gjetjet e këtij studimi tregojnë se disa nga studiuuesit e intervistuar kanë bashkëpunim me profesor dhe studiuues të huaj, dhe disa prej tyre publikojnë artikuj si bashkë-autorë me profesorë të huaj në revista ndërkombëtare. Aktivitetet kërkimore shtrihen nga pjesëmarrja në konferenca për të prezantuar studimet e tyre, deri te publikimi i artikujve dhe librave në revista me karakter ndërkombëtarë. Por, që në mungesë të mbështetjes institucionale, këto bashkëpunime më shumë vijnë si rezultat i bashkëpunimeve individuale dhe duket të jenë të limituara.

#### **4. Përfundimet dhe rekomandimet**

Kosova ka krijuar strukturat themelore ligjore dhe institucionale që kanë potencial për të rigjallëruar dhe intensifikuar edhe më tej praktikën e kërkimeve, vlerësimin e të njëjtës, dhe zbatimin në terren me rëndësi kyçe për zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Ndonëse strukturat ekzistuese kanë nevojë të përsosën, ato janë të mjaftueshme për të ushtruar funksionet kyçe të kërkimeve. Si në shumica fusha, zbatimi dhe funksionalizmi i strukturës normative dhe institucionale në rrafsh praktikë mbetet një problematikë e përgjithshme.

Përfundimet e këtij studimi vënë në pah kufizime të konsiderueshme në përmasat dhe cilësinë e kërkimeve ekzistuese. Kjo është konfirmuar si nga observimet e mbështetur në raport të ndryshme, po ashtu edhe nga informacionet empirike të mbledhur përmes intervistave dhe bisedave me përfaqësues të institucioneve akademike, qeveritare, dhe të pranive relevante ndërkombëtare.

Me pak fjalë, ky studim ka arritur në përfundimet për një nivel të ultë, marginal, të kërkimeve dhe një rol shumë modest të kërkimeve ekzistuese në proceset ose veprimtaritë shoqërore dhe/ose institucionale në Kosovë. Siç është theksuar në seksionet e mësipërm të këtij studimi, këto probleme janë derivat i një sërë faktorësh, disa prej të cilëve përfshijnë: investimet e pamjaftueshme në fushën e kërkimeve; mungesën e operacionalizimit të strukturave ekzistuese institucionale me qëllim rritjen e efektshmërisë përmes kryesisht krijimit dhe funksionalizimit të qendrave kërkimore në institucione ose njësi akademike, të cilat do të bashkërendonin dhe nxisnin kërkimet; mungesën e personelit të mjaftueshëm, të kualifikuar (si p.sh. mungesa e njohurisë së gjuhës angleze) dhe të përkushtuar ndaj punës së kërkimit; mungesën e mobilitetit apo të bashkëpunimit të nevojshëm me institucione akademike ndërkombëtare; dhe mungesën e pajisjeve të nevojshme laboratorike. Për më tepër, mungon një praktikë e institucionalizuar e

---

<sup>69</sup>Intervistë me Ferdije Zhushi – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe Profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012); Intervistë me Rexhep Gashi – Profesor në Fakultetin Juridik. (Prishtinë: 16/10/2012).

planeve personale të hulumtimit dhe nuk ka matje ose analizë të vlerës praktike të kërkimeve të zhvilluara. Në përgjithësi, nuk ka të dhëna ose statistika më sistematike në lidhje me publikimet dhe rezultatet akademike dhe shkencore.

Të gjithë këta faktorë kanë qenë me ndikim vendimtar në pjesëmarrjen e reduktuar të personelit akademik të përfshirë në kërkime, për cilësi të pamjaftueshme për sa u përket qëllimeve ose fushave të synuara (siç janë përcaktuar veçanërisht në Planin Kombëtar të Shkencës), dhe për ndikim të pavërejtshëm të kërkimeve ose rezultateve të kërkimeve në sferën e zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore, por edhe në rrafshet e tjera si mjekësia, energjia dhe mjedisi.

Për të ndryshuar gjendjen ekzistuese, ky studim ofron rekomandime të cilat janë në koherencë të plotë me shkaktarët apo faktorët që gjenerojnë gjendjen e rëndë të kërkimeve për momentin aktual në Kosovë. Në fakt, rekomandimet e këtij studimi i drejtohen në radhë të parë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Këshillit Kombëtar të Shkencës; Universitetit të Prishtinës dhe bartësve të tjerë publikë dhe privat të arsimit të lartë në Kosovë. Gjithashtu, këto rekomandime mund të ju shërbejnë edhe donatorëve të ndryshëm ndërkombëtar dhe institucioneve të tjera të interesuara në hartimin e projekteve dhe strategjive të tyre mbi fushën e kërkimeve shkencore në Kosovë. Në esencë, rekomandimet e mëposhtme provojnë të identifikojnë kurën apo ilaçon rreth shkaqeve të gjendjes së rëndë të kërkimeve në Kosovë.

- Alokimi i një *fondi* të posaçëm publik për kërkime është i ngutshëm. Ky fond do të mbështeste ose inkurajonte personelin akademik të universiteteve (publike apo private) dhe institucioneve të tjera kërkimore-shkencore që të orientonte potencialin akademik në fushën e kërkimit. Përveç mbështetjes që mund të ofrohet në formën e çmimeve ose shpërblimeve të ndryshme për të arritura në fusha të ndryshme të dijes, fondi mund të hapë procese konkurruese, dhe të alokojë mjete mbi bazë të meritës. I njëjti fond rekomandohet të përmbajë një komponent e cila synon konsolidimin gradual të institucioneve kërkimore me pajisje të nevojshme laboratorike dhe *infrastrukturë* tjetër të nevojshme për të rritur intensitetin dhe cilësinë e kërkimeve;
- Ngjashëm, bartësit privat të arsimit të lartë do të duhej të alokonin linja buxhetore apo *fonde* të veçanta për fushën e kërkimeve shkencore dhe përmirësimin e *infrastrukturës* së tyre laboratorike. Në esencë, kjo do të mund të rregullohej ose të integrohej edhe si obligim ligjor për këto institucione në ndonjërin nga aktet relevante ligjore që mbulojnë këtë fushë-veprimtari (p.sh. në *ligjin për veprimtarinë kërkimore-shkencore*), ose me ndonjë akt të veçantë nënligjor;
- Meqë *ligji për veprimtarinë kërkimore-shkencore* është në proces të amendamentimit, atëherë RIDEA ofron që rekomandimi vijues të përfshihet brenda këtij ligji: rekomandohet që përveç institucioneve publike, qasje në fondet e MASHT-it apo institucioneve tjera publike për punë kërkimore, të kenë edhe institucionet e pavarura siç janë OJQ-të, think-tank dhe të ngjashme. Për pasojë, një politikë e tillë do të mund të



nxiste konkurrencë më të madhe në fushën e kërkimeve shkencore që do të mund të ndikonte pozitivisht edhe në cilësinë e kërkimeve;

- Njësitë akademike të universiteteve rekomandohet që të themelojnë *qendra apo institute* të ndryshme profesionale dhe kërkimore, të cilat do të shërbenin si forum për bashkërendimin e veprimtarive kërkimore të anëtarëve të personelit akademik të institucionit, si dhe do të kujdeseshin për aplikime për fonde ose konsulencë profesionale në fushat përkatëse të ekspertizës. Në varësi të profilit të anëtarëve të personelit, përgatitjeve të tyre dhe aspektit numerik, njësitë akademike preferohet që të themelojnë më shumë se një qendër që merret me kërkime. Këto qendra apo institute kërkimore përveç tjerash do të mund të shërbenin si ura lidhëse mes punës kërkimore, tregut dhe institucioneve private dhe publike;
- Njësitë akademike të universiteteve duhet të *strukturojnë* në një mënyrë më efikase procesin e veprimtarive kërkimore të anëtarëve të personelit akademik përmes *raporteve planifikuese* të secilit anëtar drejtuar katedrave ose departamenteve përkatëse dhe përmes organizimit të takimeve të rregullta të personelit akademik, ku prezantohen rezultatet e punëve kërkimore;
- Në mënyrë që të përmirësohet *kualiteti i kërkimeve*, profesorët universitar duhet që të integrojnë në kërkimet e tyre, studentët e nivelit Master dhe sidomos studentët e nivelit të doktoratës. Në këtë drejtim, rekomandohet edhe rritja e numrit të trajnimeve afat-shkurtra në çështje të metodologjisë hulumtuese, gjuhëve të huaja dhe tema të tjera, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve kërkimore;
- Në kuadër të universiteteve dhe institucioneve tjera arsimore, varësisht nga profili i tyre qendrat apo institutet kërkimore (por pavarësisht përkatësisë etnike) rekomandohet që të krijojnë *asociacione kërkimore* me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit, harmonizimit dhe koordinimit të veprimtarisë kërkimore në Kosovë;
- Universitetet dhe institucionet e tjera arsimore duhet të krijojnë një *sistem unik gradimi* ku puna kërkimore është pjesë e përgjithshme e vlerësimit profesional të stafit akademik. Me fjalë tjera, *procesi i avancimit* të stafit akademik me thirrje të reja akademike duhet të jetë kompatibil apo në përputhje me punën e tyre kërkimore;
- Njësitë akademike, përfshirë përmes fondeve publike dhe mjeteve të tjera, duhet të përqendrohen në rritjen e cilësisë (aty ku ekzistojnë) ose riaktivizimin e publikimit të *revistave akademike*. Gjithashtu, nëpërmjet bashkëpunimit me universitete dhe institucione të ndryshme kërkimore ndërkombëtare këto revista akademike më së paku duhet të jenë me recension ndërkombëtar;
- Në mënyrë që të filloj ndërkombëtarizimi i revistave akademike dhe shkencore në Kosovë, rekomandohet gjetja e rrugëve alternative për të aplikuar dhe marrë kodin

ndërkombëtar *ISSN*. Një alternativë e mundshme do të ishte shikimi i mundësisë për të aplikuar për *ISSN* ndërkombëtare që duket se nuk lidhet me hapësirën gjeografike të ndonjë shteti të caktuar. Për më tepër, një alternativë e dytë do të mund të ishte aranzhimi i një marrëveshje me një shtet mik të Kosovës (Austria apo Shqipëria) që përkohësisht revistat akademike dhe shkencore që botohen në Kosovë të regjistrohen me *ISSN* të atij vendi. Në këtë linjë, rekomandohet edhe integrimi i revistave akademike dhe shkencore nga Kosova në platforma të ndryshme digjitale me mbulim ndërkombëtar (p.sh. CEEOL, SSRN, Web of Science, etj);

- Institucionet e akredituara për të ofruar studime të nivelit të doktoratës, duhet të synojnë të rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të promovojnë programe të përbashkëta studimi në nivelin e *doktoratës*;
- Universitetet dhe institucionet e tjera arsimore ose kërkimore rekomandohet që të krijojnë bashkëpunime që kanë për qëllim një *mobilitet* më të madh të studentëve dhe stafit akademik;
- Përmes fondit publik ose mjeteve të donatorëve, universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë ose institucionet e ndryshme kërkimore duhet të investojnë në *bibliotekat* e tyre manuale dhe elektronike, përfshirë parapagimin në të paktën publikimet/revistat kyçe ndërkombëtare të fushës;
- Përfundimisht, në këtë aspekt i rekomandohet MASHT-it dhe akterëve të tjerë relevant organizimi i *trajtimeve* afatshkurtra për përgatitjen e hulumtuesve dhe studiuesve rreth draftimit të aplikacioneve të ndryshme për grante shkencore të nivelit ndërkombëtar (fondet nga korniza FP7 e Komisionit Evropian, fondet nga RRPP dhe fondet e ngjashme nga institucionet austriake).

## 5. Bibliografia

Agjencia e Akreditimit e Kosovës (2009) *Raport vlerësimi i grupit të ekspertëve që vlerësuan Universitetin e Prishtinës në procesin e ri-akreditimit*. E disponueshme:

[http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi\\_i\\_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB\\_Prishtin%EBs](http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi_i_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB_Prishtin%EBs)

(vizituar më 30. 10. 2012).

Agjencia e Akreditimit e Kosovës (2012) *Raport mbi procesin e akreditimit/riakreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë dhe programeve të tyre të studimit në vitin 2012*, Nr 489/12, Prishtinë 24. 07. 2012. E disponueshme:

<http://www.akreditimi-ks.org/> (vizituar më 30. 10. 2012).

Agjencia e Akreditimit e Kosovës (2012) *Raport mbi akreditimit Institucional dhe Programor, Universiteti Publik i Prishtinës – Fakulteti Ekonomik* Qershor 2012. E disponueshme:

[http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi\\_i\\_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB\\_Prishtin%EBs:Fakulteti\\_Ekonomik:Procedura\\_e\\_vlersimit\\_2012](http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi_i_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB_Prishtin%EBs:Fakulteti_Ekonomik:Procedura_e_vlersimit_2012) (vizituar më 30. 10. 2012).

Agjencia e Akreditimit e Kosovës (2012) *Raport mbi akreditimit Institucional dhe Programor, Universiteti Publik i Prishtinës – Fakulteti Juridik* Qershor 2012. E disponueshme:

[http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi\\_i\\_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB\\_Prishtin%EBs:Fakulteti\\_Juridik:Procedura\\_e\\_vlersimit\\_2012](http://www.akreditimi-ks.org/?Vlersimi_i_Universitetit%26nbsp%3Bt%EB_Prishtin%EBs:Fakulteti_Juridik:Procedura_e_vlersimit_2012) (vizituar më 30. 10. 2012).

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2011) *Ligji Nr. 04/L-037 Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës*, Nr. 14/9. E disponueshme :

<http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20arsimin%20e%20larte%20%28shqip%29.pdf> (vizituar më 30. 10. 2012).

Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës (2011) *Ligji Nr. 2004/42 Për veprimtarinë kërkimore – shkencore*. E disponueshme:

[http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=35&Itemid=28](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=35&Itemid=28) (vizituar më 30. 10. 2012).

Intervistë me Agim Gashin – Profesor në Departamentin e Pedagogjisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 17/10/2012).

Intervistë me Arben Hajrullahun – Profesor në Fakultetin Filozofik (Prishtinë: 8/10/2012).

Intervistë me Arbnora Krasniqi-Loshaj - Koordinatore për programin e ekonomisë në Kolegjin Victory (Prishtinë: 11/10/2012).

Intervistë me Bajram Kosumin - Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë - Profesor në Degën e Gazetarisë (Prishtinë: 9/10/2012).

Intervistë me Basri Çapriqin - Profesor në Fakultetin Filologjik të Prishtinës - Ish Kryetar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 12/10/2012).

Intervistë me Besnik Limaj – Udhëheqës i projekteve vendore në WUS Austria (Prishtinë: 15/10/2012).

Intervistë me Bujar Dugollin – Dekan i Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 4/10/2012).

Intervistë me Bajram Ukën – Dekan i Fakultetit Juridik, profesor i së Drejtës Penale (Prishtinë: 16/10/2012).

Intervistë me Eda Vulën – Profesoreshë në Fakultetin e Edukimit, e nominuar si anëtare e Këshillit të Shkencës (Prishtinë: 24/10/2012).

Intervistë me Ferdije Zhushin – Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe profesoreshë në Fakultetin e Biologjisë (Prishtinë: 9/10/2012).

Intervistë me Fetah Podvoricën – Profesor i demografisë në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 15/10/2012).

Intervistë me Frashër Demaj – Hulumtues në Institutin e Historisë së Kosovës (Prishtinë: 9/10/2012).

Intervistë me Furtuna Mehmetin – Zyrtare në komisionin për cilësi në Kolegjin ISPE (Prishtinë: 13/10/2012).

Intervistë me Gëzim Aliun - Hulumtues i pavarur shkencor në Degën e Letërsisë, Instituti Albanologjik (Prishtinë: 17/10/2012).

Intervistë me Ilire Vincën – Profesoreshë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës (Prishtinë: 19/10/2012).

Intervistë me Ismet Poterën - Zv. drejtor i Institutit Pedagogjik (Prishtinë: 8/10/2012).

Intervistë me Kimete Canaj – Koordinatore e projekteve Tempus (Prishtinë: 11/10/2012).

Intervistë me Mensur Nezirin - Ekspert në Qendrën për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë QITT (Prishtinë: 10/10/2012).

Intervistë me Milazim Krasniqin – Shef i Degës së Gazetarisë në Fakultetin Filologjik, ish anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 04/10/2012).

Intervistë me Murteza Osdautaj - Departamenti për Shkencë dhe Teknologji - MASHT (Prishtinë: 17/10/2012).

Intervistë me Fadil Musën - Prodekan për çështje mësimore në Fakultetin e Bujqësisë (Prishtinë: 11/10/2012).

Intervistë me Mo Vazirin – Zv. president për çështje akademike dhe zhvillimore pranë Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) (Prishtinë: 17/10/2012).

Intervistë me Ragip Gjoshin - Këshilltar Politik në MASHT (Prishtinë: 11/10/2012).

Intervistë me Rexhep Gashin – Profesor në Fakultetin Juridik (Prishtinë: 16/10/2012).

Intervistë me Rrahman Paçarizin – ish Prorektor për Mësim në Universitetin AAB, tani koordinator për shkencë. Gjithashtu ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë: 08/10/2012).

Intervistë me Safet Merovcin - Profesor i ndërmarrësisë dhe i tregjeve financiare në Fakultetin Ekonomik në UP (Ish prodekan për çështje mësimore) (Prishtinë: 22/10/2012).

Intervistë me Sali Bashotën – Drejtor i Bibliotekës Kombëtare (Prishtinë: 11/10/2012).

Intervistë me Valmir Krasniqin – Botues në revistën Probleme Matematikore (Math Problems), Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 16/10/2012).

Intervistë me Vjollca Komonin - Ish prodekane për çështje mësimore, prodekane për çështje financiare në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Prishtinë: 17/10/2012).

Intervistë me Zejnullah Grudën – Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare (Prishtinë: 17/10/2012).

Këshilli Britanik Kosovë (2010) *Licensimi dhe Akreditimi sipas ligjit mbi arsimin e lartë në Kosovë 2002 – 2009* Profesor Steve Bristow - Udhëheqës i shërbimeve inspektuese - Këshilli Britanik i akreditimit për edukim të pavarur, të mëtutjeshëm dhe të lartë. E disponueshme:

[http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Raporti\\_i\\_Steve\\_Bristow\\_për\\_Licencim\\_dhe\\_Akreditim.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Raporti_i_Steve_Bristow_për_Licencim_dhe_Akreditim.pdf)  
(vizituar më 30. 10. 2012).

Këshilli i Akreditimit Britanez (2008) *Projekt Raporti i Akreditimit për Kosovë*. E disponueshme:

<http://ebookbrowse.com/kosovo-accreditation-project-report-pdf-d108481192> (vizituar më 30. 10. 2012).

Këshilli Kombëtar i Shkencës (2010) – *Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës*, Prishtinë 30. 03. 2010. E disponueshme:  
[http://www.masht-gov.net/advCms/documents/PKSH\\_FINAL\\_Shqip.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/PKSH_FINAL_Shqip.pdf) (vizituar më 30. 10. 2012).

Komisioni Evropian (2011) *Raporti i Progresit për Kosovën 2011*. E disponueshme:  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/ks\\_rapport\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf)  
(vizituar më 30. 10. 2012).

Komisioni Evropian (2012) *Raporti Analitik për Kosovën 2012*. E disponueshme:  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_feasibility\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf)  
(vizituar më 30. 10. 2012).

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2011) - *Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2011-2016*. E disponueshme:  
[http://www.masht-gov.net/advCms/documents/PSAK\\_2011-2016.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/PSAK_2011-2016.pdf) (vizituar më 30. 10. 2012).

## 6. SHTOJCA

### PYETËSORI

1. Sipas mendimit tuaj, cila është gjendja e kërkimeve (akademike ose shkencore) në Kosovë?
2. Në rast matjeje numerike, në shkallën 1 deri në 10, me sa do të vlerësonit praninë ose përmasat e aktiviteteve hulumtuese apo kërkimore në fushën tuaj të ekspertizës apo kompetencës?
3. Sa mendoni që hulumtimet e zhvilluara aktualisht në Kosovë janë relevante apo të rëndësishme në fushën tuaj të ekspertizës apo kompetencës?
4. Sa mendoni që kërkimet e zhvilluara në fushën tuaj të ekspertizës, kompetencës apo interesimit janë relevante apo të rëndësishme për zhvillimet më të gjera shoqërore apo ekonomike në vend?
5. Në rast matjeje numerike, në shkallën 1 deri në 10, me sa do të vlerësonit rëndësinë apo relevancën e kërkimeve ekzistuese në Kosovë për fushën tuaj (në kuptim të origjinalitetit të tyre, implikimeve praktike apo ndikimit)?
6. Në rast matjeje numerike, në shkallën 1 deri në 10, me sa do të vlerësonit rëndësinë e kërkimeve ekzistuese në fushën tuaj për zhvillimet e përgjithshme në Kosovë (sociale, ekonomike, etj.), ose zhvillimet në fushën përkatëse në shkallë vendi?
7. Cilat janë mangësitë apo mungesat ekzistuese në fushën e nxitjes dhe rritjes së veprimtarive kërkimore në Kosovë?
8. Në raste matjeje numerike, në shkallën 1 deri në 10, me sa do të vlerësonit veprimtarinë kërkimore/hulumtuese të kolegëve tuaj të fushës?
9. Personalisht, a keni ndonjë plan të punës në sferën e kërkimeve dhe publikimeve?
10. A ka praktikë institucionale në institucionin tuaj për raportim të **(a)** planeve për kërkime ose projekte hulumtuese dhe **(b)** të rezultateve në fushën e kërkimeve në çfarëdo intervali kohor (qoftë gjashtë mujor, një vjeçar apo më shumë ose më pak)?

11. Në institucionin tuaj, a ka buxhet specifik për kërkime dhe publikime shkencore? A ka revistë të karakterit akademik që publikon punimet nga fusha e gjerë e studimit?
12. Në rast se institucioni juaj publikon revistë akademike, në shkallën 1 deri në 10, me sa do të vlerësonit cilësinë e saj? A ka recension ndërkombëtar të revistës nga kolegët e fushës suaj studimore?
13. Në rast se ka, në çfarë përmasa ekziston bashkëpunimi ndërmjet institucionit tuaj dhe institucioneve të tjera (ndërkombëtare) në fushën e kërkimeve?
14. Personalisht, a bashkëpunoni me studiues apo profesor të huaj në fushën e kërkimeve? E ndërlidhur me këtë, a publikoni ose a keni publikuar, dhe nëse po, në çfarë përmasa, me profesor apo studiues të huaj dhe në revista të huaja?
15. Për sa i përket ekspertizës suaj, publikimeve ose rezultateve të publikimeve apo studimeve tuaja, a jeni kontaktuar ndonjëherë nga institucionet e Kosovës, qofshin publike apo private? Me fjalë të tjera, a është konsultuar ekspertiza juaj nga institucionet vendëse (private apo publike)?
16. Në rast se institucionet vendëse kanë kërkuar ekspertizën ose këshillat tuaja, a mendoni që ky proces këshillimi ka qenë substancial? Me fjalë të tjera, a është marrë parasysh, a ka prodhuar ndikim dhe/ose në çfarë përmasa ka prodhuar ndikimin ekspertiza apo studimet tuaja?
17. Për përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e vëllimit të kërkimeve në fushën tuaj të ekspertizës apo interesimit, çfarë veprimesh institucionale konsideroni se janë të nevojshme të ndërmerren?
18. Në rast se do të mund të ngushtonit listën e përparësive më të ngutshme apo urgjente në fushën e kërkimeve, cilat do të ishin **tri fushat kryesore** ku do të duhej ndërhyrja e ngutshme institucionale?
19. A keni ndonjë sugjerim në lidhje me ndonjë dokument që e konsideroni si relevant për temën e këtij studimi? Gjithashtu, a keni ndonjë sugjerim për ndonjë person që mund të kontribuoj për këtë hulumtim?
20. A mund t'ju citojmë me emrin tuaj të plotë dhe pozicionin që keni? Apo preferoni që t'ju referohemi vetëm me një pozicion apo emërtim më të përgjithshëm?